



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:120756
Datë: 14.12.2020
Numri i dokumentit: 01342123

C.nr.352/18

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësve N. S nga Gjilani,, Z. S nga Gjilani,, Rr. K nga Gjilani, M. K nga Gjilani, Sh. K nga Gjilani, , N. M nga Gjilani,’, A. M nga Gjilani, F. S dhe N. H nga Gjilani, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av. Halit Azemi nga Gjilani, kundër të paditurës K. K. për D. dhe F. me E. E... Sh.A.(KEDS) në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit juristi D. R..., me objekt kontesti, kompensimi i dëmit, në prezencën e të autorizuarit të paditësve dhe të autorizuarit të paditurës, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, më datë 04.11.2020, mori ndërsa më datën 24.11.2020, e përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve N. S nga Gjilani,, Z. S nga Gjilani,, Rr. K nga Gjilani, M. K nga Gjilani, Sh. K nga Gjilani, , N. M nga Gjilani,’, A. M nga Gjilani, F. S dhe N. H nga Gjilani, që të gjithë nga Gjilani, ndaj të paditurës KEDS/Distrikti në Gjilan.

DETYROHET e paditura K. K. për D. dhe F. me E. E.... Sh.A.(KEDS) në Prishtinë, që në emër të dëmit të shkaktuar –djegien e paisjeve shtëpiake nga energjia elektrike të bëjë kompensimin e dëmit material në shumë të përgjithshme prej **2,307.00 €**, paditësve edhe ate:

1.N. S për djegien e një receiver 20 €, një llap top 20 €, një modem me ëi-fi 150 €, një shtëpizë e kompjuteri 85 €, në shumë të përgjithshme 275.00 €;

2.Z. S për djegien e një TV.Telefunken(njësia e furnizimit) +servisimi 71€, frigorifer 40 litra (motori+mbushjame freon) në shumë prej 48 €, një frigorifer i kombinuar(motori+mbushja me freon) në shumë 70 €, një modem i rrjetit 20 €, dhe një TP link ëi-fi 15€, vlerën e përgjithshme prej 224.00 €;

3.Rr. K për një frigorifer i kombinuar 70 €, një aspirator i kuzhinës 120€, një televizor 71 €, e në shumë të përgjithshme prej 261.00 €;

4.M. K - për një frigorifer i kombinuar 70 €, një shtëpizë të kompjuterit 85 €, dhe 1 monitor i kompjuterit 40 €, e në shumë të përgjithshme 195.00 €;

5.Sh. K-për djegien e një frigoriferi 53 €, një enë larëse 100 €, në shumë të përgjithshme 153.00 €;

6.N. M për djegien një aspiratori të kuzhinës 120 €, pllakë e rrafshët e stufës elektrike 150 €, një llap top 120 €, sistem i kamerave 300 € dhe një bojler 30 €, në shumë të përgjithshme 720.00 €;

7.F. S-për djegien e një frigoriferi 310 litra 57 €, një reciver 20 €, modem interneti 20€, një TP link vifi 15 €, gjithësejt në shumë prej 112.00 €;

8.A. M- për djegien e një shtëpize të kompjuterit 85 €, reciveri 20 €, një modemi 20 €, një Tv 71 €, një motor uji (raketë) 300 €, një vlues uji 15 €, 8 poqa elektrik 8 €, e në shumë të përgjithshme 519.00 €;

9.N. H-për një frigorifer i kombinuar 70 €, një frigorifer 40 litra 48 €, 5 poqa elektrik 5 €, në shumë të përgjithshme 123.00 €.

Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 %, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e paraqitjes së padisë pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

II. DETYROHET e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës shumë prej 790.00 €, t'ia paguaj paditësve në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësit, përmes përfaqësuesit të tyre me autorizim, në këtë gjykatë me date 04.04.2018, kanë ushtruar padi ndaj të paditurës, për kompensim të dëmit, për shkak të një defekti më datë 04.04.2017, në shtyllën elektrike në të cilën janë të lidhur paditësit dhe nga ky defekt ka ardhur deri tek prishja e paisjeve të ndryshme shtëpiake dhe lidhur me këtë e kanë lajmëruar rastin në KEDS dhe po të njëjtën ditë ka dal komisioni në përbërje të inspektorëve S. S dhe M. R të cilët e kanë inspektuar vendin dhe kanë bërë procesverbal me datë 06.04.2017, andaj si rezultat i kësaj avarie paditësve i janë shkaktuar dëme në paisje të ndryshme shtëpiake dhe elektronike.

Gjykata në lidhje me këtë çështje duke vepruar konform dispozitave të neni 394 dhe 395 të LPK-së, të paditurës i ka dërguar aktvendim për përgjigje në padi.

E paditura në afatin e paraparë ligjor më 22.05.2018, ka paraqitur përgjigje në padi, ku e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve dhe i ka propozuar gjykatës që të njejtën ta refuzojë si të pabazuar në ligj, me arsyetimin se paditësit kësaj padie i kanë bashkangjitur vetëm procesverbalet e KEDS, ku komisioni kishte dal në vend të ngjarjes, mirëpo nuk kanë bashkangjitur fotodokumentacion për të vërtetuar se cilat paisje janë djegur si dhe nuk kanë prezentuar fatura apo pro fatura me të cilat do të vërtetohej lartësia e dëmit, andaj mbi këto baza i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet si e pabazuar.

I autorizuari i paditësve në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 04.11.2020, pas pranimit të ekspertizës së punuar nga ana e ekspertit- inxhinierit të elektroteknikës ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, lidhur me dëmin e shkaktuar për paisjet elektro shtëpiake të dëmtuara dhe ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të dëmit të shkaktuar të bëjë kompensimin e të hollave si vijon: për paditësit **N. S** në emër të dëmit të shkaktuar për një receiver, një llap top, një modem me ëi-fi dhe një shtëpizë e kompjuterit, vlerën e përgjithshme prej 275 €, paditësit **Z. S** për një televizor Telefunken, një frigorifer 40 litra, një frigorifer i kombinuar, një modem dhe një ëi-fi, vlerën e përgjithshme prej 224 €, paditësit **Rr. K** për një frigorifer i kombinuar, një aspirator dhe një televizor, vlerën e përgjithshme në të holla prej 261€, paditësit **M. K** për një frigorifer i kombinuar një kompjuter- shtëpiza dhe monitori, vlerën e përgjithshme prej 195 €, paditësit **Sh. K** në emër të dëmit të shkaktuar për një frigorifer dhe një enëlarëse vlerën e përgjithshme prej 153 €, paditësit **N. M** në emër të dëmit të shkaktuar për një aspirator, pllak e shporetit elektrik, një llap top, sistemi i kamerave dhe një bojler vlerën e përgjithshme në të holla prej 720 €, paditësit **A.M** në emër të dëmit të shkaktuar për një shtëpizë të kompjuterit, një receiver, një modem, një motor i ujit- tip raketë, një televizor, një vluese e ujit dhe 8 poqa elektrik, vlerën e përgjithshme prej 519 €, paditësit **F. S** në emër të dëmit të shkaktuar për një frigorifer 310 litra, një reciver, modemi me ëi-fi, vlerën e përgjithshme prej 112 €, paditësit **N. H.** për një frigorifer i kombinuar, një frigorifer i vogel 40 l, poqa elektrik, vlerën e përgjithshme prej 123 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Gjithëashtu i njëjti i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës duke i specifikuar edhe atë: për përpilimin e padisë shumë prej 135 €, për taksë gjyqësore shumë prej 100 €, për ekspertizë gjyqësore shumë prej 150 €, për 3 seanca nga 135 € sipas TOA-së, gjithësejtë në shumë prej 790.00 €.

Perfaqësuesi i të paditurës në përgjigjen në ekspertizë të datës 30.06.2020 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor ka kundërshutur kërkesëpadinë e paditësve si dhe ekspertizën e nxjerrë nga eksperti i elektroteknikës ingj.N. K ...nga Gjilani, duke theksuar se eksperti ka qenë në vendshiqim ku ka biseduar me paditësit rrethë diegies së paisjeve, ku edhe i ka pyetur se a i kanë riparuar paisjet elektrike dhe a posedojnë fatura për riparimin e tyre, ku disa kanë theksuar se posedojnë fatura për riparimin e tyre ndërsa disa nuk kanë poseduar, eksperti listën e çmimeve refente të paisjeve elektrike dhe çmimet e servisimit të tyre i ka nxjerrë nga tregjet rajonale dhe janë krahasuar me ato vendore, sipas mendimit të tyre një ekspertizë e tillë është e paqëndrueshme, është e bazuar vetëm në procesverbalet e KEDS-it, dhe në dëshmitë e paditësve pa shfrytëzuar prova tjera materjale dhe i ka propozuar gjykatës që të dëgjohet eksperti lidhur me konstatimin dhe mendimin e tij të paraqitur me shkrim në ekspertizën e datës 08.06.2020.

Në cilësi të ekspertit është dëgjuar N. K,... i cili në mes tjerash ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë ekspertizës së punuar me shkrim të dt. 08.06.2020, duke theksuar se ekspertizën e tij e ka punuar në bazë të procesverbaleve për verifikim të dëmit, pasi që paisjet e djegura nuk kanë ekzistuar, më tutje ka theksuar se paditësit fatura nuk kanë pasur, përveq njërit i cili kishte bërë riparimin e një llaptopi në vlerë prej 120 € dhe përgjegjësia e operatorit KEDS ka theksuar se

shtrihet deri tek njehsori dhe kjo ka ndodh si pasojë e rënies zero(0), e që shkaktar mund të jetë era, shiu, mos shtrëngimi mirë dhe shumë faktorë të tjerë.

Në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar M. R., i cili mes tjerash ka deklaruar se nga ekipet e intervenimit është informuar se përqesi zero ka qenë i këputur, të cilin përqes ekipet e kanë riparuar, mirëpo gjatë kohës sa ka qenë i këputur ka shkaktuar dëme në paisjet shtëpiake elektrike në atë lagje, më tutje ka theksuar se përqesin e kanë riparuar menjëherë dhe kanë formuar komision ku kanë evidentuar paisjet të cilat janë djegur gjatë rënies së tensionit të cilat paisje janë të ndieshme dhe djegen me mbitension. Po ashtu ka cekur se natën kritike ka qenë erë e madhe dhe përqesi zero është këputur dhe i njëjti ka shkaktuar djegien e paisjeve dhe në bazë të kodit të shpërndarjes përgjegjësia e operatorit shtrihet deri te njehsori i konsumatorit, ashtu që përgjegjësia e këtij defekti ekskluzivisht bie mbi KEDS-in.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë edhe të drejtë gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave dhe ate: Procesverbalet mbi verifikimin e dëmit të konsumatorit i datës 04.04.2017 me numër ..., ..., ..., ..., ..., ..., ..., ... si dhe Ekspertiza e ekspertit ng.i dipl.N. K... e datës 08.06.2020.

Pas vlerësimit me kujdes të secilës prove veç e veç dhe të gjithave së basku në kuptim të nenit 8 të LPK-ës dhe në bazë të rezultatit të procedurës së zhvilluar kontestimore, gjykata konstatoi këtë gjendje faktike se në mes të palëve nuk është kontestues fakti se shkaktimi i dëmit ka ardhur për shkak të shkëputjes (neutralit) zero dhe gjatë kohës sa ka qenë i këputur ka shkaktuar dëme në paisje shtëpiake elektrike pasi që natën kritike ka pas shi dhe erë të forte(vis major).

Poashtu nuk ishte kontestuese as fakti se paditësit me kërkesën e tyre te dates 04.04.2017 ishin drejtuar të paditurës, pasi që inspektorët e KEDS-it, kanë bërë verifikimin e dëmit të konsumatorve e që një gjë e tillë vërtetohet nga procesverbalet mbi verifikimin e dëmit të konsumatorve të datës 04.04.2017 me numër ..., ..., ..., ..., ..., ..., ...,

Mirë po kontestuese mes palëve ndërgjyqëse ishte mos bashkangjitja e fotodokumentacionit në procesverbalet e inspektoreve te KEDS-it dhe vërtetimi i paisjeve të djegura, mirëpo gjykata një pretendimi të tillë nuk ia fali besimin pasi që punëtorët gjegjesisht inspektorët e të paditurës në përgjegjëstë e tyre të punës kanë pasur për obligim që t'i marrin të gjitha të dhënat e nevojshme lidhur me dëmin e shkaktuar paditësve e në rastin konkret në përpilimin e procesverbaleve të cekin edhe vlerën e dëmit si dhe t'iu bëjnë foto paisjeve të dëmtuara.

Gjykata vërtetoi gjendjen faktike se deri tek dëmi ka ardhur për shkak të këputjes – përqesit zero i cili e mban sistemin e ekuilibuar të tensionit të ... , ashtu që me rastin e këputjes pajisjet të cilat kanë qenë të kqyura me sistemin një fazor e që për shkak të ndryshimit të tensionit janë dëmtuar në tërësi, fakt i cili konfirmohet nga procesverbalet e të paditurës dhe nga ekspertiza e Ekspertit të Elektroteknikës Inxh. dipl. N. K... e datës 18.06.2020 dhe vet deklarata e ekspertit e dhënë në sesancën mbi shqyrtimin kryesor të dt. 04.11.2020, ku eksperti gjyqësor në detaje ka konstatuar se si ka ardhur deri tek prishja e aparateve të amvisërisë, duke theksuar ekspertet e KEDS kanë konstatuar se ka pasur nderpreje të zeros ne shtyllën elektrike të parë dhe këtë e cekin edhe në procesverbalet e secilit konsumator, po ashtu ka cekur se ndërprerja e zeros

rrezikon djegien e të gjitha paisjeve elektrike një fazore të cilat janë aktive në momentin e ndërprerjes së zeors, sepse krjohen ‘‘ mbitensione dhe ‘‘ nën tensione’’, e që paisjet që mund të djegen për shkak të zeros janë: rrobalarësja, frigoriferi, mirkovala, fshesa elektrike, kompjuter, llap top etj.

Faktin se ka ndodhur shkëputja e përqesit zero e konfirmojnë edhe vet përpiluesit ë procesverbalit të vendit të ngjarjes të cilin gjykata e ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarit M. R, të cilës dëshmi gjykata ia fali besimin e plotë pasi që i njejt i në mënyrë të detajuar ka përshkruar inspektimin e vendit të ngjarjes dhe i njejt është hulumtues profesional për hulumtimin e shkaqeve të dëmit meqë i njejt në dëshmin e tij ka cekur se gjatë kohës sa ka qenë i këputur përqesi elektrik ka shkaktuar dëme në paisjet shtëpiake elektrike në atë lagje, dhe ka theksuar se përqesin e kanë riparuar menjëherë dhe kanë formuar komision ku kanë evidentuar paisjet të cilat janë djegur gjatë rënies së tensionit të cilat paisje janë të ndieshme dhe djegen me mbitension. Po ashtu ka cekur se natën kritike ka qenë erë e madhe dhe përqesi zero është këputur dhe i njejt ka shkaktuar djegien e paisjeve dhe në bazë të kodit të shperndarjes përgjegjësia e operatorit shtrihet deri te njehsori i konsumatorit, ashtu që përgjegjësia e këtij defekti bie mbi KEDS-in.

Andaj sipas fakteve të vërtetuara përqesi elektrik zero është këputur jashtë sferesë së përgjegjësisë së paditësit, meqë këputja ka ndodhur në shtyllen elektrike, ku bie nën përgjegjësi të paditurës konform nenit 5.5.3.2 pika (b) të Kodit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike, ku ndër të tjera, parashihet se ‘‘në objektet afariste dhe të amvisërisë, përgjegjësia e OSSh-së, është deri në pikën e kyqjes në pjesën e pasme të njehsorit ose në anën e furnizimit të ndërprerësit kryesor (siguresave kryesore)’’.

Duke u bazuar në një gjendje të tillë faktike të vërtetuar me prova materiale dhe personale, gjykata ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar me ligj, meqë kërkesat e tilla kanë mbështetje ligjore respektivisht në nenin 154 dhe 155 të LMD /Ligji Nr. 04/L-077/ pasi që në dispozitat përkatëse shprehimisht është përcaktuar se,, *Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i demit dhe se ,, Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të.*

Andaj sipas Ligjit për Energjinë elektrike / LIGJI Nr. 03/L-201/ bartja dhe shperndarja e energjisë elektrike konsiderohen si veprimtari e rrezikshme, ashtu që zotëruesi i tyre përgjigjet sipas kritereve të përgjegjëgjësisë objektive, pra edhe pa fajin e tij.

Kurse sa i përket demit material, gjykata ka zbatuar nenin 136 të LMD, ku në dispoziten përkatëse është përcaktuar se ‘‘ kush i shkaktton dëm tjetrit ka për detyrë ta kompensojë, përveq nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij’’, ashtu që gjykata e detyroi të paditurën që paditësit t’ia kompenzoj dëmin material paditësve për prishjen e pajisjeve të amvisërisë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit. Kurse lidhur me lartësinë e kompensimit gjykata ka zbatuar dispoziten e nenit 322.3 të LPK, ngase në dispozitën përkatëse është përcaktuar se

„Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër. Andaj meqë paditësi ka vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadisë, kurse e paditura ka kundërshtuar kërkesëpadinë edhe nga fakti se dëmi është ardhur si pasojë e fuqisë natyrore / vis major/ dhe pa fajin e të paditurës, mirëpo sipas gjykatës këto pretendime nuk qëndrojnë dhe janë të pabaza, ngase e paditura ushtron veprimtari të rrezikshme dhe përgjegjësia e saj matet sipas kriterëve të përgjegjësisë objektive, pra nuk është me rëndësi se nga kush është shkaktuar dëmi, por është e rëndësishme fakti se paditësit nuk kanë pasur faj të konstatuar lidhur me shkaktimin e dëmit material dhe se nuk i ka kontribuar në asnjë formë shkaktimit të dëmit, p.sh. me mbingarkesa të palejueshme apo me kyqje ilegale në rrjetin shpërndarës të energjisë elektrike.

Andaj, e paditura është e detyruar në kompensimin e këtij dëmi nga fakti se baza juridike e kërkesëpadisë është vërtetuar dhe se tani e paditura qëndron në detyrim për kompensim konform dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Kamata prej 8% në vit është përcaktuar konform nenit 382 të LMD.

Gjykata vendosi që konform nenit 452.1 të LPK, shpenzimet e procedurës kontestimore ti paguajë e paditura, edhe atë: për padi në shumë prej 135 €, për taksë gjyqësore 100 €, për ekspertizë gjyqësore shumë prej 150 €, për 3 seanca nga 135 € sipas TOA-së, gjithsejtë në shumë prej 790.00 €.

Nga të cekurat e lartshënuara u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Gjiilan, Departamenti i ërgjithshëm
C.nr.352/18, më datë 04.11.2020**

Gjyqtarja
Floriqe Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.